



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1164/14 prot.

Datë 01.06.2026

V E N D I M
Nr. 736/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.06.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 600/2026, datë 07.05.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Ankimues: Operatori ekonomik Aleksandër Harizi me Nipt. L91401023I dhe adresë Lagjja Fushas, Rruga Fushas - 1, Godine private nr.57, kodi postar 1035, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Tirana Parking.
Rruga “Ali Begeja”, Ndërtesa Nr. 16, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 600/2026, ku vendosi:

“[....]

1. Të mbyllë çështjen për pjesët e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik Aleksandër Harizi për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Aleksandër Harizi, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues Aleksandër Harizi.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 230/14 prot., datë 19.05.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomi “Aleksandër Harizi” p.f. mbi procedurën e prokurimit me objekt ‘Mirëmbajtje e software të sistemit të parkimit”, protokolluar me tonën nr. 1164/6 prot., datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor, Tirana Parking njofton se ka zbatuar vendimin Nr.600/2026, datë 07.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

I.3. Në datë 25.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 709/2026, ku vendosi:

[....]

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.*
2. *Autoriteti kontraktor të publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcën me modifikimet përkatëse sipas përcaktimeve në vendimin nr. 600/2026, datë 07.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.....[....]

I.4. Me shkresën nr. 230/15 prot., datë 19.05.2026 me objekt “Zbatimi i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.709/2026, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e software të sistemit të parkimit”, protokolluar me tonën nr. 1164/6 prot., datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor, Tirana Parking njofton se ka zbatuar vendimin Nr.600/2026, datë 07.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 230/15 prot., datë 19.05.2026 me objekt “Zbatimi i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.709/2026, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e software të sistemit të parkimit”, protokolluar me tonën nr. 1164/6 prot., datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor, Tirana Parking njofton se ka zbatuar vendimin Nr.600/2026, datë 07.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr.600/2026, datë 07.05.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Tirana Parking ka zbatuar vendimin Nr.600/2026, datë 07.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

